



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.829/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Zyhdi Haziri kryesues, Ymer Hoxha dhe Afijete Sada-Gllogjani anëtarë, me pjesëmarrjen e Zyrtares Ligjore Fitore Isufi, duke vendosur përkitazi me apelin e Adnan Lahu, kandidat për anëtarë të Kuvendit Komunal në Vushtrri, nga radhët e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, dega në Vushtrri, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), me nr. 2232/2017 të datës 08.11.2017 pas shpalljes së rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Anëtarët e Kuvendit Komunal të mbajtura më datë 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur më 12.11.2017, mori këtë:

V E N D I M

I. Pranohet si i bazuar apeli i Adnan Lahu, kandidat për anëtarë të Kuvendit Komunal në Vushtrri, nga radhët e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, dega në Vushtrri.

II. Urdhërohet Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) që të rinumëroj vetëm fletëvotimet për kandidatët për anëtar të Kuvendit Komunal në Vushtrri, nga radhët e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), dega në Vushtrri, në Vendvotimet: 2701B/09R dhe 2709B/02R.

III. Rezultati i cili del pas rinumërimit të fletëvotimeve në kutitë e votimit, në Vendvotimet si në pikën -II- të këtij dispozitivi, të përfshihen në rezultatin përfundimtar.

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar apelin ZL.Anr.829/2017 me 10.11.2017, e parashtruar nga Adnan Lahu, kandidat për anëtarë të Kuvendit Komunal në Vushtrri, nga radhët e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), në të cilën pretendon se rezultatet e votave të numëruara nga KVV në vendvotimet e Vushtrrisë dhe ato të rinumruara në QNR janë në rregull, mirëpo me rastin e publikimit të rezultateve përfundimtare nga KQZ me datën 09.11.2017, ka mospërputhje të votave të tij, në këto vendvotime: 2701B/09R dhe 2709B/02R.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i shqyrtoj pretendimet ankimore dhe materialin zgjedhor e pas vlerësimit të gjithanshëm të tyre gjeti se:

Apeli është i bazuar.

Paneli gjeti se pretendimet ankimore janë të bazuara, pasi që pas shqyrtimit të provave dhe shkresave të lëndës, ka konstatuar se ka mospërputhje të rezultateve të shpallura nga KQZ-ja me Formularët e Rezultateve të Kandidatëve dhe Formularit Përfundimtar të Rezultatit, andaj mbi këtë bazë dhe në mbështetje të nenit 117.4 të LZP-së, PZAP-i urdhëron KQZ-në, që të bëhet rinumërimi i të gjitha fletëvotimeve për kandidatët nga radhët e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) në vendvotimet e cekura më lartë dhe rezultati i dalur nga rinumërimi të përfshihet në rezultatin përfundimtar të Zgjedhjeve Lokale të datës 22.10.2017.

Andaj PZAP nga këto arsye, dhe në mbështetje të nenit 117.4 urdhëron që të bëhet rinumërimi i fletëvotimeve për vendvotimet e lartcekura si në pikën II të dispozitivit.

Prandaj më qëllim të evitimit të këtyre lëshimeve të lartë cekura dhe bazuar në nenet 115.1, dhe nenin 119.5 të LZP-së, ku parashihet se, *PZAP-i mundet që sipas vendimit të tij të shqyrtoj çështje të cilat përndryshe janë nën juridiksionin e tij kur kjo është rreptësisht e domosdoshme për të parandaluar padrejtësi serioze* po ashtu lidhur me nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

ZL.Anr.829/2017 më datën 12.11.2017

Kryesuesi i Panelit
Zyhdi Haziri



Udhëzim Juridike:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.*